

Informacione të tjera për pjesëmarrësit në studim

Informacionet për studimin FinMONIK

Studimi FinMONIK zbatohet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies (THL). Për këtë studim, janë zgjedhur rastësisht 13 600 persona që kanë lindur jashtë shtetit, me të dy prindërit të lindur jashtë shtetit. Të dhënat e tua u morën nga Qendra e Regjistrimit të Popullsisë.

Studimi mbledh informacione të besueshme për mirëqenien dhe shëndetin e të huajve, për aftësinë e tyre për të punuar dhe kapacitetin funksional, për përdorimin e shërbimeve dhe për përvojat e tyre. Po ashtu mblidhen informacione për punësimin dhe pengesat e mundshme për të gjetur punë, si dhe për përvojat e mundshme të diskriminimit. Me ndihmën e këtyre informacioneve mund ta përmirësojmë promovimin e aftësisë së të huajve për punë dhe kapacitetin funksional, si dhe zhvillimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Studimin e financon Ministria e Çështjeve Ekonomike dhe Punësimit (TEM), komunat dhe Fondi i BE-së për Azilin, Migrimin dhe Integrimin (AMIF). Informacionet nevojiten për promovimin e shëndetit dhe mirëqenies, përmirësimin e shërbimeve dhe monitorimin e integritit. Rezultatet do të shpallen në vitin 2019.

Përgjigjet e tua janë të rëndësishme dhe konfidenciale

Në të gjitha fazat e procesit të studimit, të dhënat e tua do të përpunohen në fshehtësi të plotë, duke respektuar Ligjin mbi të Dhënat Personale. Në dosjet dhe statistikave të studimit nuk përfshihen të dhënat personale, por në to përdoret një numër i ndryshëm i studimit. Identiteti yt nuk mund të njihet nga informacionet e mbledhura. Nga rezultatet e studimit, nuk mund të identifikohen informacionet e dhëna nga të anketuarit e veçantë dhe as identiteti i askujt. Studiuesit kanë detyrim ligjor që të ruajnë sekretin. Të dhënat origjinale të studimit do të ruhen përherë në Institutin Kombëtar për Shëndetin dhe Mirëqenien. Zbulimi i zakonshëm i informacionit nuk do të bëhet duke u bazuar në të dhënat e tua dhe të dhënat nuk do të zbulohen asnjëherë jashtë shteteve të BE-së apo ZEE-së.

Gjithashtu, pjesëmarrjen në studim mund ta anulosh në çdo kohë, duke lajmëruar për këtë studiuesin përgjegjës për studimin ose menaxherin e studimit. Informacionet e tyre të kontaktit gjenden në këtë letër.

Bashkimi i të dhënave në regjistra

Me **pëlqimin** tënd, rezultatet e tua të studimit mund të bashkohen me të dhënat e mbajtësve të tjerë të regjistrave: Instituti Kombëtar për Shëndetin dhe Mirëqenien (të dhënat lidhur me trajtimet e sëmundjeve, vizitat te mjeku dhe veprimet e bëra), Instituti i Sigurimeve Shoqërore i Finlandës (të dhënat për asistencat dhe kompensimet e paguara), Instituti i Statistikave i Finlandës (të dhënat për shkollimet dhe profesionet, pozitën social-ekonomike dhe shkaqet e vdekjes), Qendra Finlandeze për Pensionet (të dhënat për pensionet, rehabilitimin dhe marrëdhëniet e punësimit), Administrimi i Tatimeve (të dhënat për tatimin), Qendra e Regjistrimit të Popullsisë (emri, data dhe vendi i lindjes, adresa, gjinia, gjendja martesore, gjuha amtare, nënshtetësia) dhe Ministria e Çështjeve Ekonomike dhe Punësimit (të dhënat për punësimin dhe masat përkatëse). Për bashkimin e të dhënave, kërkohet leje e veçantë nga secili mbajtës i regjistrave.

Të dhënat e regjistrave të bashkëngjitura me të dhënat e studimit FinMONIK me pëlqimin tënd:

Regjistri	Të dhënat
THL	Të dhënat e Regjistrit të Daljes nga spitali/Regjistrin të Kujdesit Shëndetësor (HILMO, për periudhën kohore 1994–2023), ku përfshihen diagnozat dhe veprimet e bëra, të dhënat nga Regjistri i Vizitave në Kujdesin Themelor Shëndetësor (AvoHilmo, për periudhën kohore 2011–2023), të dhënat e Regjistrin Finlandez për Kancerin (për periudhën kohore 1953–2023) për kanceret e diagnostikuara, të dhënat e Regjistrin të Depistimit të Popullsisë (periudha kohore 2004–2023 për gratë e përfshira në modelin e FinMONIK), ku përfshihet nëse personi ka marrë pjesë në një depistim të kancerit, të dhënat e Regjistrin Mjekësor të Lindjeve (për periudhën kohore 1987–2023), ku përfshihen vitet e lindjes dhe të dhënat e monitorimit të një shtatzënie, të dhënat e Regjistrin të Shtatzënive të Ndërprera (për periudhën kohore 1983–2023), ku përfshihet nëse personi kishte ndërprerje të nxitur të shtatzënisë dhe sterilizim, në cilat vite u krye, të dhënat e Regjistrin të Sterilizimeve (për periudhën kohore 1987–2023). Të dhënat e Regjistrin të Sëmundjeve Ngjitëse (për periudhën kohore 1980–2023), ku përfshihen rastet me HIV, hepatit A, B, C, sifiliz, malarie dhe tuberkuloz, të dhënat e Regjistrin të Asistencës Sociale (për periudhën kohore 2006–2023).
Tilastokeskus (Institucioni Statistikor i Finlandës)	Të dhënat për shkollimin, trajnimin dhe profesionin, pozitën social-ekonomike, shkaqet e vdekjes (për periudhën kohore 2010–2023)
KELA (Instituti i Sigurimeve Shoqërore)	Të dhënat e sigurimeve, asistencës për invalidët, asistencës për kujdesin e pensionistëve, të dhënat e rehabilitimit, të dhënat nga një regjistër i kompensimit të një norme të veçantë të shpenzimeve për barnat, të dhënat nga regjistri i recetave për barnat e përdorur në shërimin e sëmundjeve më të shpeshta, të dhënat e Regjistrin të Raporteve Mjekësore dhe arsyet e raporteve mjekësore (për periudhën kohore 2010–2023)
VRK (Qendra e Regjistrimit të Popullsisë)	Gjendja martesore, historiku i martesave, banorët e tjerë të banesës, numri total i banorëve në banesë, numri i të miturve në banesë (për periudhën kohore 2010–2023)
TEM (Ministria e Çështjeve të Ekonomisë dhe Punësimit)	Të dhënat e papunësisë (kodet e punësimit të aplikuesit për punë dhe ndryshimet përkatëse); të dhënat e aplikuesve për punë (të dhënat themelore, shkollimi, diagnozat) dhe të dhënat e punësimit (trajnimet për punësim, profesionet në të cilat kërkohet punë, periudhat e provës në punë, vlerësimi i aftësisë për punë) dhe ndryshimet përkatëse. (për periudhën kohore 2010–2023).